



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 28.05.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 03413000-8- Dru zjarri.

VLERA E FONDIT LIMIT: 37,805,936 (*tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë*) Lek pa TVSH ose 396.081 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 28.05.2026, me kurs këmbimi 95.45 Lek

Arsyetimi ligjor për mosndarjen në lote të procedurës së prokurimit

Bazuar në nenin 39 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, autoriteti kontraktor ka detyrimin që, gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe planifikimit të prokurimit, të shqyrtojë mundësinë për ndarjen në lote të një procedure, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël ekonomikë në procesin e prokurimit.

Megjithatë, në rastin konkret, objekti i prokurimit është **"Blerje dru zjarri e pellet për QEA"**, dhe pas një analize të plotë teknike dhe ekonomike, autoriteti kontraktor ka vendosur të mos e ndajë këtë prokurim në lote, për këto arsye:

1. **Objekt i përbashkët dhe përdorim i integruar:** Dru zjarri dhe pelleti janë mallra me funksion të njëjtë, të përdorura për qëllime ngrohjeje në institucionin përfitues. Përdorimi i tyre është i ndërlidhur dhe i integruar në mënyrën e menaxhimit dhe shpërndarjes së furnizimit. Si i tillë, ndarja në lote nuk do të sillte një përfitim praktik ose operacional për institucionin.

2. **Efiçencë ekonomike dhe menaxhuese:** Një procedurë e unifikuar për blerjen e të dy llojeve të lëndës djegëse mundëson një administrim më të lehtë të kontratës, ulje të kostove administrative dhe sigurimin e një përgjegjësie të vetme kontraktuale për realizimin e furnizimit. Ndarja në lote do të sillte rritje të ngarkesës administrative dhe të mundësisë për vonesa në furnizim.
3. **Tregu dhe kapacitetet e ofruesve:** Nga një analizë paraprake e tregut rezulton se operatorët ekonomikë që operojnë në këtë fushë zakonisht ofrojnë të dy llojet e produkteve, ndaj ndarja në lote nuk do të sillte rritje të ndjeshme të konkurrencës, përkundrazi, mund të rezultonte në fragmentim të panevojshëm të procedurës.

Në përfundim, duke marrë parasysh natyrën e objektit të prokurimit, nevojën për një menaxhim të unifikuar të furnizimit dhe analizën e tregut, **mosndarja në lote e kësaj procedure përputhet me parashikimet e nenit 39 të Ligjit Nr. 162/2020**, dhe realizon në mënyrë më efiçente dhe efektive objektivat e prokurimit publik.

Argumentimi:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në vijim të Urdhrit nr.174 datë 07.05.2026 protokolluar nr.6100 prot., “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”, grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, e filloi punën për hartimin e dokumentacionit duke pasqyruar në të dhe ndryshimet përkatëse.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Vendimin të Këshillit Bashkiak, Bashkia Durrës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimine buxheti të Bashkisë Durrës për vitin 2026”.
2. Dokumentat lidhur me preventivin dhe specifikimet teknike, të hartuar nga grupi i punës në Bashkinë Durrës.

Përllogaritja e vlerës së fondit limit:

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

- a) çmimet e tregut; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi dhe në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

- 1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
- 2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbështet në hetimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa kompanive (testim tregu).

Në Përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një tabelë komplekse të grumbullimit të zërave të mallrave bazuar në një metodologji të paracaktuar, për objektin e prokurimit me titull: “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”, vlera e përgjithshme rezulton të jetë: **37,805,936** (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH ose 396.081 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 28.05.2026, me kurs këmbimi 95.45 Lek.

Afati për realizimin e kontratës do të jetë 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

duke filluar nga data 15 Nëntor,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndyshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për*

Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 8. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 40 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kësaj kontrate është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të kontratës përkatëse është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me këtë nen. Sa më lartë, nga ana e Njesisë së Prokurimit është arsyetuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke iu referuar faktit se në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së kontratës në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “...Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë

të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin e fundit financiar, përfshirë këstet e maturuara, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40 pika 4 e VKM nr.285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të kësaj kontrate është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Drejtues mjeti për kategoritë e mjeteve të kerkuara 2(dy)
- b. Punonjës me dëshmi kualifikimi përpunues druri të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik (ose ekuivalenti i tij/saj) 2(dy)
- c. Punonjës të thjeshtë 1(një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: kontratë pune individuale si dhe të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kerkohet ne baze te zberthimit te preventivit dhe grafikut te shperndarjes, për arsye se furnizimi eshte ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 3 (tre) persona, për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtypcës 9.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të specifikimeve/preventivit dhe të grafikut të shpërndarjes, për arsye se furnizimi eshte ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve, sipas punonjesve te mesiperm.

2.3.4 Operatori Ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- a. Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton copë 1 (një)
- b. Automjete (ATP) me masë maksimale të autorizuar deri në 3.5 ton copë 1 (një)

në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, siguracion, taksa, pronësia).
- Për të konfirmuar disponimin e mjetit të marre me qira ose kontratë bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqiten edhe Kontrata e qirase/ Kontrate Bashkëpunimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mësipërme kërkohen, duke u bazuar në planim e shpërndarjes për arsye se furnizimi është ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë/disponojë:

- a. Certifikatë ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, e vlefshme ose ekuivalente. Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatë: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, **për prodhim peleti**, e vlefshme ose ekuivalente. Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues peleti duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj), e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, Website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesat e cilësisë, ISO 9001

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e investimit/kontratës. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 9001 e **prodhimit per pelet** është e vlefshme për Autoritetin Kontraktor pas disponojmë kaldaja me pelet të standarteve të kohës të cilat kërkojnë një cilësi prodhimi të caktuar, për të pasur rendimentin e duhur.

2.4.2 Për arsye se furnizimi mund të jetë ditor dhe në orë të përcaktuara për të gjithë institucionet e varesisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve, kërkohej që ofertuesi te deklarojë me anë të një deklarate që ka gjendje apo mund të sigurojë brenda periudhës së kërkuar sasinë e kërkuar të mallit, ose kontratë furnizimi të vlefshme deri në përfundimin e kontratës. Për këtë pikë Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë vendodhjen e mallit të shoqëruar me Ambiente magazinimi dhe deklarimin e gjendjes të mallit që kërkohej, në mënyrë që të verifikohet nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Sipas “Specifikimet teknike” (Drutë e zjarrit; Të mos jenë të kalbura dhe të jenë të thata) me qëllim që drutë e zjarrit të jenë në magazinë të mbrojtur nga lagështira dhe të vijnë të thata në institucion, lehtësisht për t’u verifikuar nga institucioni. Lagështira në brendësi të druve të zjarrit nxjerr tym gjatë djegies dhe si pasojë sjell probleme në shëndetin e fëmijëve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për procedurën me objekt “Blerje dru zjarri e pelet për QEA” janë hartuar nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, e ngritur me urdher nga titullari I autoritetit kontraktor, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, mbi bazën e nevojave reale të institucioneve arsimore dhe parashkollore në administrim të Bashkisë Durrës. Këto specifikime janë përcaktuar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe mosdiskriminimit.

Për sa i përket druve të zjarrit, është kërkuar që ato të jenë dru ahu ose dushku, pasi këto lloje sigurojnë fuqi më të lartë kalorifike, djegie më të mirë dhe eficiencë më të lartë në ngrohje. Përmasat e përcaktuara për gjatësinë dhe diametrin janë vendosur në funksion të përshtatjes me sobat ekzistuese të institucioneve, me qëllim garantimin e përdorimit normal dhe të sigurt. Gjithashtu, kërkesa që drutë të jenë të thata dhe jo të kalbura lidhet me rritjen e rendimentit të djegies dhe shmangien e dëmtimeve të pajisjeve.

Specifikimet teknike të peletit janë hartuar në përputhje me parametrat teknikë të kaldajave ekzistuese, me qëllim sigurimin e një djegieje efikase dhe funksionimi normal të sistemeve të ngrohjes. Parametrat e kërkuar për lagështirën, densitetin, vlerën kalorifike dhe nivelin e hirit janë përcaktuar për të garantuar cilësi, rendiment termik dhe ulje të kostove të mirëmbajtjes.

Sasitë e druve dhe peletit janë përllogaritur mbi bazën e numrit të pajisjeve ngrohëse, normës së konsumit, orëve të funksionimit dhe periudhës së ngrohjes për secilin institucion. Këto përllogaritje pasqyrojnë nevojat reale për garantimin e kushteve normale të ngrohjes gjatë sezonit dimëror.

Në përfundim, specifikimet teknike dhe kriteret e përcaktuara konsiderohen të domosdoshme, proporcionale dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës publike, duke garantuar furnizim cilësor, përdorim eficient të fondeve publike dhe funksionim normal të sistemeve të ngrohjes.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Shënim: Ne cdo rast qe mund te permendet emer marke/prodhuesi ose "Importi", "Cilësi e I-rë", Standard kombëtar apo nderkombetar, refewrime të tilla shoqërohen dhe do të pranohen edhe ekuiivalente.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit